

Shazie GURI  
Biblioteka e Akademisë së Shkencave

## **Promovimi i trashëgimisë biblio-dokumentare të Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, si një mundësi e njohjes së kulturës së popullit shqiptar**

Historia dhe gjuha e shqiptarëve, edhe pse pjesë e pandashme e historisë mijëra vjeçare të Evropës, e madje e ndodhur shpesh në epiqendrën e zhvillimeve historike të saj, u bë e njohur relativisht vonë. Kjo për shkak të kufizimeve që i vendoste këtij procesi një faktor i rëndësishëm politik: Shqipëria asokohe nuk ishte ende një shtet i pavarur e autonom, e rrjedhimisht historia edhe kultura e saj u pa vetëm në kuadrin e Perandorisë Osmane, brenda së cilës ajo ndodhej. Ndonëse ishin të shumtë shqiptarët me kontribute në zhvillimin e kulturës e teknologjisë qysh nga lashtësia deri në Rilindjen evropiane, ndonëse ata kishin dhënë kontribute të konsiderueshme dhe kishin luajtur një rol të rëndësishëm në fatet e Perandorisë Romake e asaj Bizantine, ndonëse luftërat ngadhënjimtare antiosmane të shqiptarëve në shekullin e XV ishin një faktor themelor në përcaktimin e rrjedhimeve evropiane të invazionit osman, Shqipëria kishte mbetur një vend pak i njohur nga Evropa. Por Evropa që po kuptonte më në fund se bota në të cilën jetojmë është e ndryshme në kohë, dëshironte të dinte edhe të kaluarën e saj. Evropa që kishte çliruar mendjen e saj nga paragjykimet për t'u mbështetur tërësisht në arsyen, hyri në periudhën e iluminizmit, duke bërë të vetën idenë e zhvillimit progresiv në historinë njerëzore, ide që ndikoi në kthesën që nisi shkenca historike në shekullin XVIII.

Duke ditur që historia, kultura dhe gjuha e shqiptarëve ishin fare pak të njohura, dhe të vetëdijshëm për rëndësinë që kishte njohja e tyre për të kuptuar historinë dhe kulturën e Evropës në tërësi, nga shekulli XVIII e posaçërisht nga shekulli XIX, dijetarë nga një numër vendesh të Evropës, nisën kërkime për aspekte të ndryshme të jetës materiale e kulturore të popullit shqiptar e të Shqipërisë. Këto janë dhe fillimet e njohjes së historisë dhe gjuhës së shqiptarëve nga shkenca evropiane, dmth fillimet e studimeve albanologjike.

Pra, termi albanologji përfshin tërësinë e studimeve që kanë bërë dhe bëjnë për historinë, gjuhën dhe kulturën e popullit shqiptar studiuesit e huaj dhe studiuesit shqiptarë. Studimet albanologjike zënë fill aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX, si një drejtim i veçantë i studimeve për Shqipërinë, shqiptarët dhe gjuhën shqipe. Gjej rastin këtu të citoj disa nga figurat e mëdha të albanologjisë italiane, si Carlo Tagliavini, Giuseppe Valentini, Leotti, Fulvio Cordiniano, Gaetano Petrotta, Giovan Battista Pellegrini, Italo Costante Fortino etj., të cilët kanë dhënë një kontribut të madh për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, ashtu siç vazhdojnë të japin edhe në ditët e sotme studiues të tjerë italianë.

Do të dëshiroja të përqendrohesh tani në atë pjesë të buletinit të përgatitur nga ana e bibliotekës së Akademisë së Shkencave, në kuadër të projektit Interreg III A Itali - Shqipëri 2000-2006 BiblioDoc-Inn., për të shpjeguar më mirë përmbajtjen e botimeve shqiptare të pasqyruar në të. Cilido që është i interesuar për t'u njohur me këtë përzgjedhje të parë të këtyre botimeve, mjafton të shfrytëzojë web sitin e bibliotekës Teca del Mediterraneo : <http://www.bcr.puglia.it>.

Artikujt dhe monografitë e përzgjedhur për këtë buletin, që i përkasin fushës së albanologjisë, tentojnë të njohin çdo të interesuar me etnogjenezën e popullit shqiptar, historinë, gjuhën, letërsinë, artin dhe kulturën e lashtë të këtij populli.

Duke parë dy grupet e mëdha të shkencave albanologjike, që janë shkencat historike dhe ato gjuhësore, vëmë re se trashëgimi shkencor-linguistik në lëmin albanologjik është më i pasur se ai historiografik. Kjo epërsi është përcaktuar nga lindja dhe zhvillimi i gjuhësisë historike krahasuese, veçanërisht nga sukseset e gjuhësisë indoevropiane. Gjuha shqipe, si përfaqësuese e vetme e një dege shumë të vjetër të familjes së gjuhëve indoevropiane, paraqet një interes të veçantë për indoevropianistët dhe luan një rol vendimtar për zgjidhjen e disa problemeve kyçe të ballkanistikës.

Nëpërmjet studimeve albanologjike të bëra në këto fusha, është hedhur dritë në sqarimin e mjaft problemeve të vështira si etnogjeneza e popullit shqiptar, autoktonia e tij në viset e sotme si edhe prejardhja e gjuhës shqipe. Për sqarimin e këtyre problemeve gjuhësia shqiptare është ndihmuar dhe ndihmohet nga parahistoria, historia, paleografia, paleontologjia, antropologjia, mitologjia, epigrafia, arkeologjia, numizmatika, toponimia, etnografia, folklori, onomastika. Studimet e kryera dhe botimet e realizuara për këto probleme janë të shumta, ndërsa te ky buletin përfshihen një pjesë fare e vogël e tyre.

Buletini informon të interesuarit për mundësinë e shfrytëzimit në site interneti të revistave, që janë botime të instituteve të Akademisë së Shkencave, me karakter albanologjik si Studia albanica, Studime historike, Studime filologjike, Kultura popullore etj., ku pasqyrohen artikujt plotë studimorë, të zgjedhur nga këto revista, që trajtojnë probleme që lidhen me këto fusha. Në artikujt e revistave dhe në monografitë e pasqyruara në buletin Nr.1/2 Janar-Dhjetor 2005, vihet theksi në disa prej problemeve siç janë prejardhja dhe autoktonia e shqiptarëve në trojet ku jetojnë sot, prejardhja e gjuhës shqipe, etj.

Kështu, artikulli i revistës Gjuha Jonë: “*Shqipja standarde në kapërcyell të shekullit*” i Prof.Emil Lafes, flet për rrugën e përshkruar nga gjuha shqipe gjatë katër shekujve të historisë së saj, në të gjithë hapësirën etnike shqiptare, duke filluar që nga vendosja e alfabetit të gjuhës shqipe, rregullave të drejtshkrimit, njohjes së gjuhës shqipe si gjuhë e vetme e shtetit shqiptar, dhe zhvillimi i mëtejshëm i gjuhës letrare gjatë fazave të ndryshme të historisë e zhvillimeve politike të Shqipërisë, deri në zhvillimet e normës në rrafshet kryesore të strukturës së shqipes standarde.

Monografia me titull “*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*” e gjuhëtarit të njohur Prof. Shaban Demiraj, trajton evolucionin historik të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe,

të shoqëruar brenda caqeve të mundshme me elemente sintaksore; rrugës që ajo ka ndjekur që nga faza e dokumentuar në fazat më të hershme të saj. Për këtë qëllim janë mbajtur parasysh dhe të dhënat e gjuhësisë krahasuese indoevropiane, duke i vështruar ato të krahasuara me të dhënat e shqipes së dokumentuar, për të parë nëse ndryshimet e vërtetuara janë përfutur apo jo në përputhje me ligjet e evolucionit të sistemit fonologjik dhe të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. Janë vështruar gjithashtu edhe dukuritë gramatikore kryesore me karakter ballkanik.

Ndërsa arkeologu i njohur Neritan Ceka në artikullin e botuar në revistën *Candavia* me titull “*Dark Ages*”, faktorët kryesorë në formimin e shqiptarëve të hershëm, paraqet tablonë të gjenezës së shqiptarëve mbi bazën e etnosit ilir, duke e kërkuar këtë gjenezë në Antikitetin e Vonë, pra disa shekuj më përpara se ç’është pranuar përgjithësisht nga historiografia tradicionale. Ai shpjegon, i mbështetur në burime të padiskutueshme dokumentare të shkruara dhe në rezultatet e gërmimeve arkeologjike të kryera, dy faktorët kryesorë që fermentuan këtë proces, të cilët janë: së pari disintegrimi i Perandorisë Romake dhe i qytetërimit të saj globalizues dhe së dyti krishterimi, që ofroi modele të thjeshta të krijimit të komuniteteve pas rënies së strukturave të rënda të dominatit romak.

Po kështu, artikulli i përzgjedhur nga revista arkeologjike *Iliria*, me titull “*Teatri antik i Apolonisë*” i arkeologes Aleksandra Mano, na njeh me gërmimet arkeologjike shumëvjeçare të ndërmarra në qytetin antik të Apolonisë së Ilirisë. Në këtë qytet janë zbuluar monumente mjaft të rëndësishëm të kulturës ilire, që flasin për zhvillimin urbanistik dhe lulëzimin ekonomik e kulturor të tij. Ndër to autorja ndalet në zbulimin dhe rikompozimin në këtë zonë të disa pjesëve kryesore të një teatri të madh, i cili mendohet të jetë përdorur prej 400-500 vjetësh si vend spektakli për banorët e hershëm të Apolonisë, pa të cilin nuk mund të kuptohet jeta shpirtërore dhe kulturore e këtij qyteti.

Monografia e historianit Prof.Kristo Frashëri me titull “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu: jeta dhe vepra, 1405-1468*”, është trajtim i mbështetur vetëm në burimet dokumentare bashkëkohore, i historisë së heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe i epopesë së luftës të shqiptarëve që ai udhëhoqi në shek.XV kundër invazorëve osmanë, duke u mbështetur vetëm në burimet dokumentare bashkëkohore. Për Gjergj Kastriotin, historiografia evropiane nuk ka reshtur së shkruari me përkushtim. Në këtë punim provohet madhështia e veprës së Skënderbeut, i cili nuk trajtohet vetëm si strateg, por edhe si burrë shteti, si faktor ndërkombëtar, si ligjvënës, si administrator, por edhe si njeri. Besoj që të gjithë e dimë origjinën e disave prej banorëve të sotëm të Italisë së Jugut, të cilët ne i quajmë arbëresh. Ata nuk janë tjetër veçse shqiptarë të emigruar nga tokat e tyre pas vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Botime të tjera të përzgjedhura për këtë numër të buletinit, paraqesin aspekte të tjera të kulturës së lashtë të popullit shqiptar, si artikulli i Prof.Moikom Zeqo, që trajton disa rishikime lidhur me zanafillën e artit prehistorik shqiptar, monografia e shkruar nga studiuesi Gjijn Varfi mbi historikun e heraldikës shqiptare, etj. Kjo monografi e fundit e botuar në trajtë albumi kushtuar heraldikës shqiptare dhe problemeve të saj, synon të grumbullojë, të klasifikojë dhe rindërtojë heraldikën shqiptare, me qëllim që të mbushë

zbrazëtinë e krijuar nga pavijueshmëria e traditës heraldike, të ruajë atë çka mbetur nga kultura heraldike në Shqipëri, duke ndaluar shkatërrimin e mëtejshëm të saj, shkatërrim që ka nisur që para 500 vjetësh me shkatërrimin e shtetit shqiptar nga pushtimi osman, si edhe duke ndihmuar në rigjallërimin e heraldikës shqiptare.

Hartimi i këtij buletini, me përmbajtjen e përmbledhjeve të abstrakteve të disa prej botimeve shqiptare, mendojmë se do të japë kontributin e tij modest në promovimin e trashëgimisë biblio-dokumentare të kësaj biblioteke.